



**ADMINISTRATA RAJONALE
E ZONAVE TË MBROJTURA
ELBASAN**

Nr. 96 Prot.

Librazhd, më 24/06/2021



**UNIVERSITETI I ELBASANIT
“ALEKSANDËR XHUVANI”**


Nr. 1350 Prot.

Elbasan, më 24/06/2021

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

PËR

**“ZHVILLIMIN E NISMAVE DHE AKTIVITETEVE TË
PËRBASHKËTA”**



ADMINISTRATA RAJONALE E ZONAVE TË MBROJTURA ELBASAN e përfaqësuar nga Drejtori z. **Fatmir Brazhda**

dhe

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI", përfaqësuar nga Rektori i Universitetit, Prof. Dr. **Skënder Topi**

më poshtë referuar si palët;

Nisur nga interesat e përbashkëta, që lidhen me bashkëpunimin dhe shkëmbimin e eksperiencave, për zhvillimin e nismave dhe aktiviteteve të përbashkëta, palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Memorandum bashkëpunimi sipas dispozitave më poshtë:

NENI 1 QËLLIMI

Qëllimi i këtij Memorandumi është përcaktimi i procedurës dhe vendosja e rregullave të bashkëpunimit dypalësh, në mënyrë që të sigurohet realizimi i nismave dhe aktiviteteve të përbashkëta, në kuadër të këshillimit të karrierës dhe ofrimit të shërbimeve mbështetëse ndaj studentëve.

NENI 2 PARIME TË PËRGJITHSHME

- 2.1 Ky Memorandum lidhet për të lehtësuar marrëdhëniet ndërinstitucionale për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të palëve, me synim komunikimin dhe shkëmbimin e informacioneve, ideve dhe eksperiencave që lidhen me fushat me interes të përbashkët, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- 2.2 Ky Memorandum shërben si bazë bashkëpunimi dhe nuk krijon të drejta ose detyrime ligjore. Kjo marrëveshje nuk ndryshon ndonjë ligj ose akt nënligjor në fuqi. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë memorandum nuk çenojnë apo ndikojnë tek të drejtat dhe detyrimet, që i burojnë këtyre palëve nga kontrata/marrëveshje të tjera, apo nga legjislacioni në fuqi.



- 2.3 Palët njohin kërkesën për shkëmbimin e informacionit, bashkëpunimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, në bashkërendim me ligjet respektive ose kërkesave rregullatore.

NENI 3 FORMAT DHE MËNYRAT E BASHKËPUNIMIT

- 3.1 Bashkëpunimi midis palëve do të realizohet me anë të takimeve të përbashkëta apo shkëmbimit të informacionit.
- 3.2 Kërkesa për informacion ose takim do t'i drejtohet palës tjetër me shkrim dhe në gjuhën shqipe.
- 3.3 Kërkesa për informacion ose takim duhet të sigurojë një përshkrim të përgjithshëm lidhur me subjektin për të cilin kërkohet bashkëpunimi dhe kohën e dëshiruar për konkretizimin e bashkëpunimit.
- 3.4 Pala së cilës i drejtohet kërkesa, pasi e analizon atë, i siguron palës tjetër informacionin që ai zotëron. Në rast se kërkesa nuk mund të pranohet, pala së cilës i drejtohet kërkesa duhet t'i japë përgjigjen me shkrim palës që kërkon informacionin, në lidhje me shkaqet që e pengojnë dhënien e informacionit.

NENI 4 KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

- 4.1 Palët për zbatimin e këtij memorandumi caktojnë nga një person kontakti/koordinator për secilin institucion (Aneks I).
- 4.2 Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në vazhdimësi, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni.
- 4.3 Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e të dy institucioneve në lidhje me zbatimin e bashkëpunimit.

NENI 5 DISPOZITA TË FUNDIT

- 5.1 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.
- 5.2 Ky Memorandum mund të ndryshohet vetëm me shkrim.



NENI 6 KOHËZGJATJA DHE HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum lidhet për një afat kohor 1 (një) vjeçar dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët.

Memorandumi rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur për vitet pasardhëse, në rast se dy palët nuk shprehen me shkrim për të kundërtën.

Mosrinovimi i këtij memorandumi bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga pala e interesuar të paktën 3 muaj përpara përfundimit të saj.

Ky Memorandum hartohet në gjuhën shqipe, në katër kopje origjinale, dy për secilën palë.

Pasi u lexua, u gjend i rregullt dhe konform vullnetit të të dyja palëve, të cilat e firmosin dhe e vulosin atë respektivisht.

**PËR ADMINISTRATËN RAJONALE TË
ZONAVE TË MBROJTURA ELBASAN**

FATMIR BRAZHDA



**PËR UNIVERSITETIN E ELBASANIT
"ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORI**

Prof. Dr. SKENDER TOPI





ANEKS I

Personi i kontaktit për Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” :

Emër Mbiemër: Eda Çela

Email: eda.cela@uniel.edu.al

Tel: +355 695126263

Adresa: Rruga “Ismail Zyma”

Personi i kontaktit për Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura Elbasan.

Emër Mbiemër Bajram Kullolli:

Pozicioni: Shef Menaxhimi

Email: bajram.kullolli@gmail.com

Tel: +355 692426534

Adresa: Unaza e Qytetit Librazhd